



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 180, datë 30.10.2024**

**PËR**  
**MIRATIMIN E RIEMËRIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS**  
**TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT TË JETËS “SICRED” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të rregullores nr. 137, datë 21.12.2015 “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrës, Administratorit/Anëtarit të Bordit, të Drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e riemërimit të z. Artan Xhori në pozicionin e Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit të jetës “Sicred” sh.a., deri në datë 30.06.2025.**
- 2. Miratimin e riemërimit të z. Selman Lamaj, në pozicionin e anëtarit i Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit të jetës “Sicred” sh.a., deri në datë 30.06.2025.**
- 3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**ANËTAR**  
**Deniz DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Mimoza KAÇI**